



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:297332
Datë: 06.08.2024
Numri i dokumentit: 06021012

C.nr.2282/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Fëllanza Knushaj me bashkëpunëtoren profesionale Argjelina Prenku, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses A. Q. M. nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Agim Muhaxhiri avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria për Shëndetësi, të cilën e përfaqëson i autorizuari Musë Gjergjaj, për kompensimin e shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 1,361.00 euro, jashtë seance me datë 06.08.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses A. Q. M. nga Gjakova me të cilën ka kërkuar që të “*APROVOHET si e themeltë padia e paditëses së lartcekur dhe të DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës- Drejtoria e Shëndetësisë që paditëses të ia kompensoj tri pagat në emër të shpërblimit jubilarë, për 46 vite të përvojës së punës të pandërprerë tek punëdhënësi i fundit shumë e përgjithshme prej 1,361.00 euro, nga momenti i ushtrimit të padisë deri në pagesën definitive, e që këtë kompensim ta realizoj në afat prej 7 ditësh prej marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit si dhe ka kërkuar shpenzimet procedurale*”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja A. Q. M. në këtë gjykatë me datë 31.12.2021, përmes të autorizuarit të saj Agim Muhaxhiri, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës-Drejtoria për shëndetësi, për pagesën e shpërblimit jubilar, duke theksuar se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si asistente e stomatologjisë në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Gjakovë, me datë 30.07.1973 e gjerë me datën 24.06.2019, ku të njëjtës i është ndërpre marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit. E njëjta ka gjithsejtë 46 vite të përvojës së punës të pandërprerë tek i njëjti punëdhënës. Ka theksuar se paditëses i takon shpërblimi jubilarë pasi që duke u bazuar në kontratën kolektive sektoriale nr. 05-3815 të datës 12.06.2018,

përkatësisht neni 17, par. 3 është cekur se për përvojën e punës në institucione shëndetësore, tek punëdhënësi i fundit shpërblehet në vlerë të tri pagave mujore. Andaj ka parashtruar padi ku ka kërkuar që në emër të shpërblimit jubilar, e paditura të ia paguajë paditëses shumë prej 1,361.00 euro, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Gjakovë në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 24.02.2022, me të cilën ka theksuar se i kundërshton pretendimet e paditëses për kompensimin e shpërblimit jubilar duke theksuar se është e pakontestueshme që paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Gjakovë. E paditura kundërshtimin e padisë dhe kërkesë padisë e bazon në faktin se i mungon legjitimiteti real pasivë pasi që është dashur të paditët Ministria e Financave dhe transferove e cila ka refuzuar të bëjë ekzekutimin e vendimit të nxjerrë nga e paditura. Ka shtuar se bazuar në faktin se e paditura nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive Sektoriale, konsideron se nuk mund të obligohet që ti kompensoi pagat jubilarë. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë si të pathemeltë.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar dhe si e tillë u refuzua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura që nga data 30.07.1973, me detyra të punës si asistente e stomatologjisë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, po ashtu se e njëjta realizon pagë mujore në vlerë prej 453.91 euro dhe se i ka 46 vite përvojë pune. Po ashtu të njëjtës i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak se ka mbushur moshën e pensionimit prej 65 vjeç. Këto fakte gjykata i ka vërtetuar përmes provave që gjenden në shkresat e lëndës e që janë: Vendimi i lëshuar nga QKMF me numër 197, të datës 02.05.2019 mbi pensionimin e paditëses, vërtetimi i QKMF-së mbi paditësen për përvojën e punës me nr. 110, të datës 03.03.2020, Libreza e punës për paditësen me nr. 22691, i datës 16.11.1971. Derisa në nenin 329 par. 1 të LPK-së parashihet që: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, gjykata provave të lartcekura që kishin të bënin me vërtetimin e këtyre fakteve, i'u fali besimin e plotë, ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë nga dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale në Kosovë (KKS) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Shëndetësisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës me datën 11.06.2018 (e cila është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj), dhe në rastin konkret pati parasysh nenin 2 [Kohëzgjatja e kontratës], ku është përcaktuar se *“Afati i zbatimit të kësaj kontrate është në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjet nga*

data e lidhjes së saj, respektivisht nga momenti i nënshkrimit nga palët në këtë kontratë dhe gjen zbatim deri në lidhjen e kontratës së re”, ashtu që në bazë të këtyre dispozitave KKS-ja meqë është lidhur me datë 11.06.2018, e njëjta ka qenë në fuqi deri me datë 11.06.2021.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 399 të LPK-së ku parashihet që “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadië, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadië*”, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se “*Kërkesëpadië është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadië qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura*”, ashtu që gjykata bazuar në shkresat e lëndës, përkatësisht nga Vërtetimi i marrëdhënies së punës për paditësen lëshuar nga e paditura i datës 03.03.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja është e punësuar tek e paditura që prej datës 30.07.1973 e tutje, sipas përlllogaritjes së bërë nga ana e gjykatës i bie që 30 vitet e përvojës së punës, paditësja i ka përmbushur me datë 30.07.2003, pra në periudhën kohore që KKS-ja e fundit nuk ka qenë në fuqi, ashtu që kjo kontratë kolektive nuk prodhon efekt juridik para datës 11.06.2018.

Po ashtu paditësja nuk do të mund ta realizonte këtë të drejtë as me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës të nënshkruar me datë 18.04.2014 dhe ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe afati i aplikimit të kësaj marrëveshje është tre vjet, deri me datë 31.12.2017. Në rastin konkret gjykata gjen se paditësja me datë 30.07.2003 ka arritur 30 vite përvojë pune, ndërsa padinë në gjykatë e ka parashtruar me datë 31.12.2021, gjykata gjen se në kohën kur paditësja pretendon se ka arritur të drejtën e shpërblimit jubilar, nuk ka qenë në fuqi Kontrata Kolektive Sektoriale dhe nuk ka ekzistuar ndonjë marrëveshje kolektive tjetër.

Gjykata vlerëson se marrëveshjet/kontrata kolektive që rregullojnë këto të drejta në kompensimin qoftë për paga jubilarë nuk mund të zbatohen për asnjë kërkesë e cila lind para ose pas datave të vlefshmërisë së tyre ashtu që nuk mund të zbatohen dhe nuk krijojnë të drejta për punëmarrësit dhe detyrime për punëdhënësit dhe për kërkesat të cilat kanë lindur para se këto marrëveshje të kenë hyrë në fuqi, prandaj edhe paditësës me këto marrëveshje/kontrata nuk mund ti sigurohet baza juridike e kërkesëpadië andaj gjykata erdhi në përfundim që kërkesëpadië e paditësës është qartazi e pathemeltë, sepse e njëjta është e pa bazuar në ligj apo akte të tjera nën ligjore në fuqi dhe në mungesë të ndonjë akti tjetër juridik në fuqi që e njeh të drejtat e pretenduara të paditësës, gjykata vendosi si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e morri sipas nenit 450 dhe nenin 463 par. 1 të LPK-së.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2282/21, me datë 06.08.2024

Gj y q t a r j a,
Fëllanza Knushaj

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.